



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS  
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 27 QERSHOR 2019, në orën 10:00**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 27. JUNA 2019. GODINE, u 10:00 sati**

**QERSHOR - JUN  
2019**

## **Rendi i ditës**

1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave

## **Dnevni red**

1. Drugo glasanje Nacrt zakona o porezu na prihode korporacije

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër i Sportit, Rinisë dhe Kulturës,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme, me kërkesë të 51 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 65 deputetë.

Jemi duke proceduar me pikën e vetme të rendit të ditës:

### **1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit në të ardhurat e korporatave**

Më lejoni, të nderuar deputetë, që edhe në emër tuaj t'i përshëndesim dhe t'u dëshirojmë mirëseardhje përfaqësuesve të federatave të sportit tonë, klubeve të futbollit e klubeve të atletikës, shumicën e klubeve në Kosovë.

Mirë se keni ardhur, faleminderit shumë për prezencën tuaj.

Të nderuar deputetë,

51 deputetë të Kuvendit të Kosovës kanë parashtruar kërkesë për seancë të jashtëzakonshme për votimin në lexim të dytë të Projektligjit në të ardhurat e korporatave.

Kuvendi në seancën plenare të mbajtur më 30 maj 2019 i ka miratuar 24 amendamente të propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, po nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për votimin e amendamentit të pestë të propozuar nga deputeti Bekim Haxhiu, të cilin atë kohë nuk e kishte përkrahur Komisioni FunkSIONAL.

Ndërsa në vazhdimin e seancës plenare më 19 qershor 2019, kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Lumir Abdixhiku, deklaroi se komisioni e tërheq amendamentin e vet, të deklarohet cilin amendament e tërheq, për të cilin duhet të deklarohet seanca dhe e përkrah amendamentin pesë, të propozuar nga deputeti Bekim Haxhiu.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, Lumir Abdixhiku, që të deklarohet në lidhje me qëndrimin e komisionit për këtë amendament.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sportistë, përfaqësues të organizatave të sportit,

Më lejoni që fillimisht të bëj disa qartësime që besoj se orientojnë edhe diskutimin e sotëm dhe votimin në këtë seancë.

E para, qartësimi që duhet bërë, e që e shoh të domosdoshëm në bazë të diskutimeve që i kemi parë në publik, është se ky Kuvend nuk po e voton as Ligjin për sponsorizim, e as Ligjin për sport, çfarë ju keni referuar shpesh. Ky Kuvend është duke votuar Ligjin mbi tatimin në të ardhura të korporatave.

Pra, po votohet një tatim teknikisht për botën e financave, tatimi i dytë më i rëndësishëm pas TVSH-së.

Dhe, çështja e dytë që duhet trajtuar këtu është se votimi i tatimit në fjalë më së paku ka konotacion partiak, çfarë fatkeqësisht dhe këtu, për faj të dy kolegëve tanë, zotit Haxhiu dhe Krasniqi, ju është dhënë gjatë gjithë kohës.

Pra, po të kishte qenë ashtu, po të kishte qenë diferencë partiake, unë s'do votoja amendamentin në fjalë dhe ministri i Financave, që është nga PDK-ja, zoti Hamza, nuk do të ishte kundër amendamentit tuaj. Pra, po të ishte partiake, ministri i PDK-së, ministrin më të mirë që e keni të Financave, nuk do të ishte kundër propozimit tuaj.

Unë dua t'i qartësoj dy alternativa, në mënyrë që deputetët ta kenë të qartë për çka po votohet sot.

Alternativa e parë është alternativa që buron prej Ligjit të tatimit në korporata dhe kjo alternativë ka marrë votën shumicë dhe pa asnjë votë kundër, sa kam unë kujtesë, edhe të grupit punues dhe në grup punues kanë qenë gjithë anëtarët e të gjitha partive politike, të gjitha partive politike, edhe në Komision për Buxhet dhe Financa.

Dhe, sipas kësaj alternative të mbështetur prej ministrisë së Financave, prej ministrit Hamza dhe të kaluar në komision, bizneset kanë të drejtë të sponsorizojnë dhe duhet t'i adresohen veçanërisht përfaqësuesve të sportit, bizneset kanë të drejtë të sponsorizojnë klubet, organizatat, individët dhe për atë pjesë të sponsorizimit të mos paguajnë tatim, lirohen prej tatimit, pra llogaritet si shpenzim.

Ky është modeli që pak a shumë është i njohur nëpër pjesën më të madhe të vendeve perëndimore, sponsorizon një subjekt, lirohesh për atë pjesë të sponsorizimit dhe nuk paguan tatim.

Alternativa e dytë, e kjo alternativë buron prej Ligjit të sponsorizimit, që është votuar në këtë Parlament, në legjislacionin e kaluar dhe kjo alternativë na vjen si amendament i zotit Haxhiu në

Komision e në Parlament, kërkon që jo prej parave të biznesit të ndodhë sponsorizimi, por prej tatimit të ndodhë sponsorizimi. Pra, 30% e tatimit që biznesi ia paguan shtetit, të shkojnë për sport, jo biznesi jep para më tepër, po atë tatim që ka pasur t'ia paguajë shtetit, 1/3 e asaj shume ia jep sportit, kjo është alternativa e dytë.

Çka ndodh këtu? Tatimi është para e shtetit, të mos e ngatërrojmë këtë gjë, në momentin që biznesi e bën një aktivitet ekonomik, tatimi është para e shtetit.

Alternativa e dytë kërkon që këto para të shtetit të mos shkojnë fare potencialisht në buxhet, po të shkojnë drejt në sport, që i bie pak a shumë riaranzhim i buxhetit. Ka mundur që në fund të vitit të aprovohej një amendament buxhetor te ministri i Financave e të thotë e rrisim buxhetin për sport për 30 milionë, kjo është.

Prej tatimit në fitim, 30% e tatimit në fitim, tash për ta qartësuar. Tatimi në fitim në Kosovë është 100 milionë euro për korporata, vetëm për korporata dhe 30% e këtij 100-milionëshi, 30 milionë euro, është potenciali që bizneset kanë të drejtë të japin për sponsorizim.

Sipas versionit të parë të komisionit e të ministrit të Financave, 30% e fitimit bruto, ata që janë financierë e njohin si termin EBITA, fitimi para tatimit, 30% e fitimit para tatimit mund të shkojë për sponsorizim.

Ka dy anë të mira dhe unë do të sillem këtu jo si përfaqësues i një partie politike, po do të sillem si profesionist i fushës, pra edhe anë të mira, edhe pozitive në dy alternativat, dorën në zemër, si i djathë besoj sa më pak para shtetit, është më mirë dhe besoj që me mënyrën qysh po menaxhohet paraja, sa më pak para në tavolinë të shtetit, e në dorë të biznesit është më mirë.

Por, në anën tjetër, mos harroni, mundësia e marrjes së parasë prej shtetit dhe dërgimit te bizneset nuk po krijon vlerë të shtuar, pra nuk është që po i detyrojmë bizneset të japin para më tepër. Me paratë që bizneset e paguajnë si tatim, që e kanë paguar gjithmonë si tatim që ka përfunduar në buxhet, e në fund ka mundur prej buxhetit të shkojë në sport, po e shkurtojmë dhe po e dërgojmë drejt në sport, por potencialin e besimit në sport nuk po e rrisim, nuk rritet potenciali i investimit në sport kështu, bizneset nuk japin para, vetëm e kanalizojnë paranë që për tatim kanë pasur t'ia japin shtetit.

Proceduralisht, kryetar, komisioni nuk e ka tërhequr amendamentin, sepse duhet një vendim i komisionit, duhet mbledhur komisioni edhe një herë e të bëjë një gjë të tillë, nuk ka mbështetje për ta tërhequr amendamentin e komisionit. Nuk kemi përkrahje prej Ministrisë së Financave për të bërë një gjë të tillë.

Pra, Ministria e Financave nuk e mbështet amendamentin e zotit Haxhiu, komisioni nuk e mbështet amendamentin e zotit Haxhiu. Unë personalisht e kam votuar dhe kam dilema se cila është më e mira apo jo.

Por, çfarë dua të them është që proceduralisht amendamenti i komisionit është votuar në këtë seancë dhe tash kemi edhe një amendament tjetër që duhet të hidhet në votim dhe në qoftë se kalojnë këto të dyja, duhet shikuar proceduralisht në bazë të rasteve të kaluara se cili amendament shkon tutje.

Dhe, për fund, për të mos e zgjatur më shumë, keqpërdorimi i parave të sponsorizuara nuk rregullohet as me alternativën e parë, as me alternativën e dytë, fatkeqësisht.

Supozoni një rast që një biznes i ka 100 mijë euro tatim të paguajë dhe vendos 30% të tatimit të mos ia japë shtetit, po t'ia japë një sporti, një personi fizik. Pra, nuk ka kriter ku mund të përfundojë kjo para dhe mund të ndodhë që, me kapacitetet e institucioneve që i kemi tani, këto para do të keqpërdoren.

Prandaj, edhe një herë kjo është edhe e vërteta e dy alternativave, për juve të sportit të dy alternativat kanë të bëjnë për sponsorizim. Pra, dy alternativat e rrisin përkrahjen për sponsorizim, edhe e para, edhe e dyta.

A do të keni sponsorizim prej tatimeve që shkojnë në shtet, apo prej mjeteve që mbesin fitim bruto të bizneseve, kjo është çështja që diskutohet sot në komision. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Më lejoni, të nderuar deputetë, vetëm të bëj këtë konstatimin.

Zakonisht të gjitha gjërat, të cilat unë i lexoj, t'i keni parasysh, që nuk janë interpretime të mia si kryetar i Kuvendit. Janë interpretime të procesverbaleve të cilat merren nga mbledhjet e Kuvendit, ose vendimet e komisioneve parlamentare. Do të thotë, deklarimi se komisioni e tërheq amendamentin e vet paska ndodhur më 19 qershor nga kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, kështu po insiston edhe administrata.

Çështja është kjo, kur ta vendos amendamentin, më duhet ta vendos me këtë deklaram, se e paskemi kështu të shkruar, ndryshe, në qoftë se insistohet, atëherë më duhet një konsultim me administratën si ta vej në votim.

Urdhëro! Lumir Abdixhiku e ka fjalën.

**LUMIR ABDIXHIKU:** Faleminderit, kryetar!

Ka qenë vullnet imi që të tërhiqet amendamenti i komisionit dhe atë vullnet e kam shprehur në seancë, por nuk kam marrë mbështetje prej anëtarëve të komisionit që të tërhiqet amendamenti

në fjalë, sepse për ta tërhequr amendamentin e komisionit, duhet të mbledhet komisioni edhe ta votojë tërheqjen e amendamentit. Ka qenë vullnet imi që të hapet rrugë, por nuk ka marrë mbështetje proceduralisht, pra nuk ka pasur proces të votimit për ta tërhequr dhe vullneti im nuk mund të vlejë më tepër se sa procedurat.

**KRYETARI:** Atëherë, të keni parasysh.

Kryetari i komisionit ka shprehur vullnetin e vet, por nuk ka qenë në mbledhje të komisionit për ta marrë atë qëndrimin e komisionit përkatës. Do të thotë, unë do ta heq kur të vendosin deputetët, ka edhe disa deputetë që janë lajmëruar, do ta vendos pa përkrahjen e Komisionit Funkcional, do ta largoj “me”, kjo, ta keni parasysh.

Atëherë, po vazhdojmë, Bekim Haxhiu, në fund do ta marrësh fjalën, para votimit. Dauti, Adem Mikullovc, Daut Haradinaj, menjëherë pastaj.

Urdhëro, zoti Mikullovc!

**ADEM MIKULLOVCI:** Unë desha me thanë që të dy variantet...

**KRYETARI:** Vetëm pak, a po dëshironi grupet të shkojnë një nga një. Adem Mikullovc e ka fjalën, pastaj shkoj te grupet. Kërkoj falje, gabimi im është, vazhdo i nderuar deputet.

**ADEM MIKULLOVCI:** Unë vetëm desha të them që ky ligj, të dy variantet, cilëndo ta marrësh, mund të merret prej të dyjave nga pak, po duhet ta kemi ligjin tonë, ky ligj duhet të kalojë gjithsesi.

Po është puna te formulimi që mua nuk po më pëlqen që duhet përmirësuar një gjë. Atje thotë “u mundësohet”, u lejohej korporatave, kompanive, ndërmarrjeve të sponsorizojnë projektet sportive e kulturore. Jo “ju lejohej”, po duhet bërë obliguese, është e domosdoshme të jepen 30% për sport dhe për kulturë. Ai ato para edhe ashtu i jep, edhe ashtu ato para shkojnë. Veç ato 3 milionë, katër milionë, pesë milionë tatim që i paguan, 30% të jenë obliguese, e jo “i mundësohen”, se kjo i jep mundësi malverzimeve, i jep mundësi të paguajë një projekt, një ndeshje që i bëhet 5 euro, 20 euro, 100 euro, 1000 euro, e jo 100 mijë euro, e jo të instalohet nxehja qendrore në të gjitha hallat sportive nëpër Kosovë.

Nuk di a munda ta sqaroj mirë, apo jo? Kryesore, kërkesa ime është që të jetë e domosdoshme, obliguese, kjo është kryesore.

**KRYETARI:** Faleminderit, zoti Mikullovc! Zoti Hoti, fjala për ju!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Më lejoni të sqaroj qëndrimin e grupit tonë parlamentar, gjatë ditëve të fundit ka pasur vërtet shumë informata të pasakta, në veçanti drejtuar grupit tonë parlamentar.

Ne e mbështesim plotësisht idenë për sponsorizim të sportit, jemi marrë edhe në Qeverinë e kaluar me këtë çështje, edhe tash qëndrojmë prapa kësaj ideje.

Arsyeja pse ky ligj është prolonguar deri tash, besoj që kryetari i komisionit, deputeti Abdixhiku, e sqaroi në detaje.

Atë që ne e kemi kërkuar që ka marrë mbështetjen edhe të komisionit është që të rritet potenciali për sponsorizim të sportit në 30% të fitimit bruto. Çka nënkupton kjo? Nënkupton mundësi për sponsorizim të sportit deri në 300 milionë euro brenda vitit.

Amendamenti i deputetit Haxhiu nënkupton 30% të tatimit në fitimi të tatimit që korporatat ia paguajnë shtetit, që është rreth 30 milionë euro, ta keni parasysh. Pra, mundësia për sponsorizim me amendamentin e deputetit Haxhiu është maksimum 30 milionë euro, me mundësinë që me amendamentin që e ka përkrahur Komisioni për Buxhet dhe Financa mundësia për sponsorizim të sportit është deri në 300 milionë euro, sa shfrytëzohet kjo mundësi, normalisht është gatishmëria e bizneseve dhe insistimi i klubeve sportive të ndryshme për të kërkuar sponsorizim. Grupi ynë parlamentar e mbështet cilindo prej varianteve, sigurisht ne do të parapëlqenim variantin që sponsorizimi të bëhet nga fitimi bruto, por ne do të japim votën dhe mbështetjen tonë për cilindo variant që hedhet këtu në votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Hoti, kur shkoi te përfaqësuesit e grupeve parlamentare, më deputetëve s'do t'ju jap fjalën. Për arsye se po stërzgjatet seanca dhe veç po maltrohen deputetët. Zoti Krasniqi, nuk jap tjetër, përveç propozuesit në fund, zoti Krasniqi, fjalën e keni.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Ministër,

Të nderuar deputetë,

Edhe mysafirë të nderuar që përfaqësoni komunitetin e sportit, më vjen mirë që po mblidhemi edhe një herë për një temë tepër të rëndësishme, ne e kemi ftuar këtë seancë të jashtëzakonshme pikërisht duke besuar fuqishëm që kjo është temë urgjente dhe duke qenë të zhgënjyer që s'kemi arritur ta kryejmë në dy seancat e kaluara kur kemi diskutuar.

Nuk do të flas shumë për këtë pjesën e historisë, se ma merr mendja njerëzit, të cilët janë duke e prituri më së shumti miratimin e këtij amendamenti dhe këtij ligji, e dinë historinë e krejt rrjedhjes të idesë së Ligjit për sponsorizime, së paku prej vitit 2009 e këndej. Ne kemi një Ligj për sponsorizime në fuqi, është miratuar në Qeverinë e kaluar, si i tillë nuk është zbatuar



asnjëherë, as nga qeverisja e kaluar, as nga kjo qeverisje. Arsyeja ka qenë refuzimi i Administratës Tatimore të Kosovës për t'i zbatuar dispozitat e këtij ligji, duke u thirrur në atë se kur ka mospërputhje, ata e respektojnë vetëm ligjin bazik. Është çështje për diskutim, sepse të dy këto ligje janë miratuar në Kuvendin e Kosovës, sidoqoftë sot jemi duke e ndryshuar ligjin bazik dhe ka një amendament, i cili e fuqizon Ligjin për sponsorizime dhe në një formë e bën pjesë të Ligjit për tatim në korporata. Zoti Abdixhiku i dha disa shpjegime dhe zoti Hoti po ashtu, ne e kemi pasur diskutime ndërmjet vetes edhe në të kaluarën. Unë do të mundohem t'jua shpjegoj për ata që s'e dinë pse Ligji për sponsorizime është mundësia e vetme që e nxit biznesin të investojë në sport, por edhe në kulturë. Sot ne e kemi një ligj në fuqi dhe sipas ligjit aktual në fuqi, që është që sa vjet në fuqi, nëse e matin me ato shifrat që dha zoti Hoti u mundësohet bizneseve të investohet deri në 200 milionë euro në sport, sot është deri në 200 milionë, se është 20%.

Sot, kontributi bamirës është 10%, edhe kontributi shtesë sipas ligjit të veçantë është 10%. Sot meqenëse kishin investuar bizneset, ashtu siç u tha, deri në 200 milionë euro në vit, kanë mundur të hyjnë në sport. Por, sa kanë hyrë në sport? Nëse s'e dini, ju tregojnë edhe ata njerëz që i kemi lart, por edhe të tjerët që i shihni çdo ditë. As 1% të kësaj shume, përveç investuesve të cilët mbajnë klube, kryesisht në futboll, që kanë një kosto pak më të madhe. Propozimi, amendamenti i komisionit thotë në mënyrë komplet të gabueshme, në kuptimin logjik të këtij ligji, thotë hajde po e bëjmë 20-shin 30%. Çka ndodh me këtë ndryshim? Thotë hajt po ua japim mundësinë bizneseve të investojnë paratë e veta në sport dhe nëse investojnë, ta zëmë, 5 milionë euro, mund t'i shpëtojnë 500 mijë. Nëse investojnë 10 milionë euro, mund t'i shpëtojnë 100 mijë. Domethënë, mjetet e veta, se këta po thonë t'ua llogarisim shpenzim, ashtu është sot, ka praktika të tilla gjithkund në Evropë, është e vërtetë, por në Kosovë kjo s'ka funksionuar, as nuk po funksionon dhe kjo është arsyeja që krejt bashkë kemi mbështetur një metodë tjetër që e parasheh Ligji për sponsorizime, e që thotë "po e lejojmë që 30% të tatimit në fitim, atë që ia ka borxh shtetit një biznes, të mos ia japë shtetit, por t'ia japë sportit dhe kulturës".

Në opsionet, të cilat i kemi këtu dhe i kanë marrë të gjithë, një model i një biznesi që gjatë vitit ka të ardhura bruto 1 milion euro, në versionin e ligjit aktual po jua them vetëm të fundit, i bie t'i marrë fitim të vetin 144 mijë euro, nëse i ka të ardhura të tatueshme 200 mijë. Në opsionin që e ka propozuar komisioni i bie të marrë edhe më pak, me këtë ligjin e ri që e ka amendament komisionit, i bie të marrë 126 mijë, në opsionin që po e propozojmë dhe që po e mbështesim ne, i bie të kenë fitim 180 mijë euro, se numrat janë kokëfortë, nuk rrejnë. Tash, më tregoni, cili biznes do të favorizonte opsionin aktual, krahasuar me opsionin që po e mbështesim ta fuqizojmë Ligjin për sponsorizime, e aq më pak propozimin e komisionit. Shqetësimet që mund t'i kenë profesionistët e fushës për çështjen që ndërlidhet me menaxhim të financave publike, janë shqetësime që i kanë argumentet e veta, por mos harroni Ligji për sponsorizime e ka një proces goxha burokratik dhe unë parimisht s'jam fort i burokracisë, por në këtë rast, arsyeja pse ka proces burokratik të verifikimit të krejt sponsorizimeve ka të bëjë me parandalimin e plotë të

keqpërdorimeve. Ky ligj s'mund të keqpërdoret ashtu siç po frikësohet dikush, sepse nuk mundet një biznes kushërinjve të vet t'u japë mjete, duke u thirrur që po e sponsorizon sportin ose kulturën. Sepse ka një proces për një sportist të sponsorizohet, duhet marrë edhe miratimi nga klubi, nga federata, në raste të caktuara e deri nga Komiteti Olimpik. Duhet shkuar tek pastaj në Komisionin ndërministror, ku janë edhe përfaqësuesit e Administratës Tatimore, të Ministrisë së Financave, të Kulturës, e kështu me radhë. Ata duhet pastaj sipas ligjit të bëjnë vlerësimin a ka benefit publik një sponsorizim i tillë dhe tek atëherë të miratohet sponsorizimi dhe, normalisht çdo pagesë bëhet përmes bankave.

Unë ju them që benefitet e këtij ligji do të jenë shumë më të mëdha se sa që po i kuptojmë sot. Këto do të ndikojnë edhe te formalizimi i punësimit në fushën e sportit. Sot ka qindra e qindra punëtorë sportivë, prej administratorëve e te trajnerët, e te sportistë të tjerë që i kushtojnë kohën më të madhe të tyre në baza ditore e të merren me sport dhe që nuk paguhen formalisht. Kjo do të krijojë mundësinë të formalizohen edhe ata, sepse kjo do t'u konvenonte klubeve, federatave, e tjerë. Kanë për të pasur dobi të drejtpërdrejta dhe po ashtu nuk humben mjetet, siç po pretendohet, se këtu po thuhet vitin e ardhshëm llogaritet ndoshta 100 milionë euro mundësia e përfitimeve nga tatimi në fitim të korporatave dhe po thuhet nëse shfrytëzohet 30%, 30 milionë euro i humb shteti. Nuk i humb shteti 30 milionë euro, shteti fiton të investojë 30 milionë euro në sport dhe në art, se mbi të gjitha, një pjesë e atyre mjeteve prapë kthehen, por një pjesë të atyre mjeteve shteti e kishte humbur po u zbatua ajo që po propozohet nga komisionit. Ta zëmë, nëse ishte zbatuar në mundësinë maksimale dhe ligji aktual, më shumë kishte humbur prej tatimit në fitim shteti se sa nga propozimi ynë.

Unë ju them me bindje të plotë, ne e kemi borxh t'ua japim këtë mundësi bizneseve, korporatave, ta mbështesin sportin, sportistët, kulturën dhe artistët, edhe aktivitetet rinore që i parasheh Ligji për sponsorizime. Dhe, nëse, po e marrim hipotetikusht, nëse kur të fillojë zbatimi më 1 janar të vitit të ardhshëm, më duket ashtu parashihet, nëse ne për një periudhë të caktuar e shohim se ka probleme, askush nuk na pengon të kthehemi në këtë Kuvend dhe t'i bëjmë plotësimet dhe ndryshimet e domosdoshme për ndonjë përmirësim eventual. Ama sot ne duhet ta votojmë këtë ligj, sot duhet votuar këtë amendament që i mundëson Ligjin për sponsorizime të jetë pjesë e ligjit bazik për tatim në korporata dhe ta obligojë Administratën Tatimore të Kosovës t'i pranojë ato kontrata të sponsorizimit sikur lirim prej pagesës së tatimit apo një pjese të tij ndaj shtetit. Unë nuk e shoh asnjë problem për këtë çështje dhe unë nuk besoj as që duhet politizuar kjo çështje. Në fund të fundit, për të mos tingëllojë që po i përsërisim, besoj që bile këtu ishte dashur të pajtohemi që e kemi obligim ta bëjmë prioritet sportin edhe kulturën. Tek e fundit, janë këta njerëz që po na përfaqësojnë më së miri dhe pa dallime partiake nëpër botë.

Unë ju kisha ftuar, të nderuar kolegë deputetë, ta votoni amendamentin numër 5, të deputetit Haxhiu, pro, dhe meqenëse proceduralisht duhet vendosur në votim edhe amendamentin e komisionit, siç e shpjegoi zoti Abdixhiku, s'ka mundur të tërhiqet, se s'është mbajtur një

mbledhje e komisionit, përkundër vullnetit që shprehet nga ai, atë ta votojmë kundër, kjo është procedura realisht që e kemi zakonisht kur ka dy amendamente. Pra, si procedurë unë besoj, zoti kryetar, ju vendosni një herë amendamentin e komisionit dhe ne do të duhej ta votojmë kundër atë amendament dhe pastaj amendamentin numër 5 ta votojmë pro. Ju lutem, që të kemi konsensus së paku për këtë çështje, e cila me të vërtetë është nga temat ndoshta më preokupuese në komunitetin e sportit dhe të kulturës këto ditë dhe besoj që, së paku këtë mund ta bëjmë ne si Kuvend për t'ua kthyer me mirënjohje konkrete krejt atyre sukseseve dhe asaj pune dhe asaj krenarie që po na japin për çdo ditë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Zoti Konjufca, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, po shkojmë nga një përfaqësues, nënkryetar, a e dëshirove fjalën? Pas Konjufcës, ok! Zoti Konjufca!

**GLAUK KONJUFCA:** Të nderuar kolegë deputetë!

Të nderuar përfaqësues të sportit, që jeni mysafirë në këtë seancë,

Natyrisht që sporti në Kosovë i ka pasur problemet e shumta, me të cilat është ballafaquar dhe unë mendoj që asnjë qeveri e deritashme nuk e ka pasur sportin prioritet. Prej kësaj rrjedhin problemet e shumta, e sidomos ato të krijimit të kushteve dhe infrastrukturës sa i përket suksesit masiv të sportit brenda Kosovës.

Ato rezultate të jashtëzakonshme, të cilat i kanë arritur disa prej sportistëve tanë, nuk lidhen drejtpërdrejt me ndonjë farë ndihme apo prioritetizimit të shtetit të Kosovës, por me punën e tyre, me ç' rast krejt çka ka ndodhur prej politikës është pas sukseseve t'i bashkohemi festës së këtyre sportistëve. Por, jo pse ka pasur këtu ndonjë orientim apo organizim të sportit me prioritetizim, ta zëmë, qysh i kemi autostradat apo asfaltin. Këtu sporti është lënë nën mëshirën e sukseseve individuale, fatkeqësisht. Edhe tash, kur erdhi ky rast krejt çka bëri një pjesë e mazhorancës është që ta fajësojë opozitën që gjendja e sportit është e keqe në Kosovë. Kjo ka qenë e neveritshme, thënë të drejtën, këto javët e fundit, si në formë të propagandës që është zhvilluar prej një pjese të mazhorancës, se kush qenka kundër këtij amendamenti, qenka kundër sportit dhe krejt ai debati u orientua a je me amendamentin apo kundër amendamentit?

Është e qartë që për këtë amendament nuk ka pasur madje konsensus as vetë mazhoranca, e dyta, unë mendoj që Qeveria është kundër këtij amendamenti, nuk është opozita kundër këtij amendamenti, para se gjithash, është Qeveria, nëse e marrim si qëndrim zyrtar të Qeverisë opinionin edhe qëndrimin e atij ministrit, i cili është kompetent dhe të cilin drejtpërdrejt e prek ky amendament, e ky është ministri i Financave, Bedri Hamza, ai është kundër këtij ndryshimi.

Dhe, tash do të kishte qenë shumë mirë që përderisa ne po e bëjmë këtë diskutim, të ishte zoti Hamza në këtë seancë dhe të na e shprehë edhe një herë mendimin e vet dhe pse ai në emër të Qeverisë është kundër këtij propozimi. Atëherë, a po i bie kjo që Qeveria është kundër sportit në Kosovë, a qysh?! Pse nuk është Bedri Hamza këtu? Unë e kam një pyetje të thjeshtë: pse të mos

na e tregojë qëndrimin e tij ai? Në të vërtetë, këtu janë edhe disa probleme konceptuale, së pari, në këtë propozim që po ndodh, të mos harrojmë që kjo do të shërbejë si justifikim në njëfarë mënyre që lënia anash nga ana e shtetit e sportit për t'u institucionalizuar tash. Pse? Sepse, kemi për ta bërë një ndryshim që bizneset private dhe korporatat të kenë në kompetencë sportin dhe pastaj shteti i lanë duart prej sportit. Unë mendoj që kështu ka për të ndodhur. Kështu ka qenë gjithmonë, por tash e keni edhe justifikimin se korporatat e marrin në dorë sportin edhe shteti nuk ka nevojë pastaj të merret me sportin.

Me të vërtetë, ky është koncept i orientimit total privat të sportit, që mua nuk më pëlqen dhe tash po jua shpjegoj pse nuk më pëlqen. Sepse, më së pari, përveç keqpërdorimeve të shumta që mund të ndodhin, e dyta frikohem se pas tri-katër vjetëve në Kosovë klubet tona të sportit nuk kanë për ta pasur më emrin “Prishtina”, “Llapi” e “Drita”, por do t'ia nisin ta kenë emrin KF “Devolli”, Z-Mobile”, edhe “ETC”. Kjo ka për të ndodhur shumë shpejt në Kosovë. Edhe këto ekipe pastaj do t'ia nisin t'i fitojnë ligat e Kosovës krejt. Këtë koncept të sportit ju po doni ta sillni në Kosovë. Unë mendoj se nuk është mirë, nuk është modeli më i mirë i mundshëm.

Tjetra është që nëse e bëjmë edhe këtë ndryshim, po frikohem qysh e keni konceptuar ju është edhe një problem tjetër, ndodh një disbalancë e madhe ndërmjet sportit dhe kulturës, a jeni duke e vërejtur? Gjithkush po i krijon kushtet për të pasur llogari për të investuar në sport, po kurrkush të mos ketë llogari të investojë në kulturë. Të investohet në sport është më e leverdishme se sa të investohet në kulturë. E kjo pabarazi që po e shkaktoni ndërmjet sportit dhe kulturës po më duket e padrejtë. Nëse do ta kisha votuar këtë amendament do ta kisha votuar veç pse sportistët po mendojnë se është i mirë dhe që u ndihmon. Mirëpo, të mos e harrojmë çështjen, krejt këtë problematikë të ndërlikuar të cilën unë po mundohem ta shpjegoj dhe e cila u shpjegua edhe paraprakisht, duhet të ju vijë pak turp që e keni thjeshtëzuar. A e dini në çfarë dimensionesh e keni thjeshtëzuar? Se, sportistët edhe nuk kanë kohë të merren me Ligjin për korporatat e të shikojnë aty në detaje çka jeni duke bërë. Sportistëve ua keni krijuar me propagandë idenë që më shumë para në sport do të ketë automatikisht, dhe kjo është më mirë. Pra, më shumë para më mirë, kaq reduktohet problemi, kështu që votojeni amendamentin.

Mirëpo, ju lutem, krejt po i shtyni disa procese që... edhe Gjykatën Speciale e patët bërë kështu, më këso metode, domethënë kundër bashkësisë ndërkombëtare, kundër demokracisë, kundër... që të argumentoni që ne jemi të pastër, e pastaj donit të hiqni, vetë donit ta hiqni, se erdh puna ashtu që pastaj vetë u detyruat të bëni përpjekje ta hiqni. Kështu që mua s'po më pëlqen kjo metodë qysh po i thjeshtoni problemet me propagandë dhe thjesht sporti tash ka për të lulëzuar, se më shumë para për sportin është më mirë. Po, duhet shikuar modelin, modelin të cilin jeni duke e aplikuar.

Kështu që, ne jse, pasi sportistët po mendojnë ashtu se është më mirë, unë do ta votoj. Edhe Vetëvendosja do ta votojë këtë amendament, mirëpo përgjegjësinë për keqpërdorime nuk do ta

marrim dhe kur ato të ndodhin përmes këtyre mekanizmave, që mund të jenë edhe mekanizma të shpëlarjes së parave, mos harroni, edhe të ikjes prej tatimeve, do të mundohemi t'i ngremë këto probleme, t'i zbulojmë ato dhe t'i rrimë gati edhe t'i përmirësojmë gabimet e kësaj Qeverie. Faleminderit!

**KRYETARI:** Glauk, e bëre një gabim të rëndë, se sportistët e dinë mirë çka del pas kësaj. S'është si ajo puna e gjykatës speciale. E dinë mirë, e dinë.

Po shkojmë te Blerimi, o jo, nënkryetari i Kuvendit, Kujtimi dhe pastaj shkojmë tutje. Në sallë është nënkryetar, ju e keni zgjedhur.

**NËNKRYETARI KUJTIM SHALA:** Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Duhet t'ua rikujtoj që Kosova e ka Ligjin nr. 05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Domethënë, në kuptimin e normës, ne këtë problem e kemi të zgjidhur. Po, pse po flasim sot, pse po debatojmë kohët e fundit? Sepse, ky ligj e ka një problem dhe ai problem është te pika 1 e nenit 12. Kjo është e para.

Ligji është miratuar më 23 dhjetor 2016, është dekretuar më 13 janar 2017, është publikuar në Gazetën Zyrtare, më 17 janar 2017. Në seancën e 23 dhjetorit, meqë unë kam qenë sponsor i ligjit si ministër i atëhershëm, jua kam tërhequr vërejtjen pikërisht për këtë problem, sepse ligji në pikën 1 të nenit 12, që i referohej atëherë amendamentit 17 binte ndesh me Ligjin për të ardhurat e korporatave. Domethënë, pata tërhequr vërejtjen që ky ligj nuk mund t'i rregullojë çështjet të cilat rregullohen me ligjin bazik, sepse bëhet i paimplementueshëm. Por, Kosova ka ligj të implementueshëm në fushën e kulturës dhe të rinisë, sepse norma prej 30% në Ligjin për sponsorizime nuk është aplikuar në ato dy fusha, por është lënë norma që lejon ligji bazik 10 + 10. Kjo është historia.

Ministria e Kulturës e ka dhe një rregullore që buron nga ky ligj, Rregulloren me nr. 01/2018 që e shtrin më tutje mënyrën se si mund të bëhen, se si duhet të bëhen sponsorizimet. Kjo është rregullorja që garanton siguri. Nuk jemi këtu në fushën e diskutimit të shpërdorimeve, ose jo. Nuk ka një rrezik specifik. Ne po bisedojmë se cila prej metodave është më e favorshme. Por tani, t'i lëmë këto dhe të kthehemi te pika themelore që na intereson. Ne kemi dy amendamente, një amendament të grupit punues, që ka përkrahjen e Komisionit Funkcional dhe që njeh 30%-shin e fitimit bruto dhe kemi një amendament, amendamentin 5 të kolegut tonë deputetit Haxhiu, që njeh 30% të tatimit në fitim. Amendamenti i deputetit Haxhiu është në përputhje me Ligjin për sponsorizimet. Çka domethënë kjo? Ne po detyrohemi sot që të ndryshojmë një ligj bazik për shkak të një ligji specifik. Kjo është paradoksale. Këto na ndodhin ne, por jemi në këtë pikë dhe duhet ta bëjmë.

Tani unë duhet ta sqaroj dhe të bëj të njohur publik edhe qëndrimin tim edhe kërkesën time për mënyrën e votimit, se çka duhet të zgjedhim. Nëse ne miratojmë amendamentin që ka mbështetjen e Komisionit Funkcional, Ligji për sponsorizime do të jetë dhe më tutje i paaplikueshëm, sepse ai njih lehtësirat në tatimin në fitim e jo tatimin në bruto. Nëse mbështesim amendamentin e deputetit Haxhiu ne do ta zhbllokojmë pengesën që ka krijuar ligji specifik. Kështu që, unë personalisht do ta votoj amendamentin e deputetit Bekim Haxhiu. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Para se të vazhdoj, jemi te Blerim Kuçi. Blerim, para se të vazhdoj, veç ta keni parasysh, në votim kur do ta vë, e vë amendamentin 5, propozimi i deputetit Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional dhe amendamenti 6, të cilin e kemi kaluar në seanca më herët, ju lutem vëmendje, mbetet pa objekt dhe fshihet. Këtë ta kemi parasysh. Kështu e vë në votim. Blerim Kuçi, urdhëro!

**BLERIM KUÇI:** Faleminderit, kryetar!

E para, mua më vjen keq që edhe ne si komision, por edhe zoti Haxhiu gjatë hartimit të këtij ligji nuk ka qenë prezent në punën tonë gjatë hartimit të Ligjit për tatimin e korporatave, sepse do t'i kishim sqaruar të gjitha detajet brenda atij procesi, por ajo ka ndodhur dhe jemi në gjendjen aty ku jemi. Disa prej kolegëve, sidomos Lumiri, i tha disa probleme dhe shqetësime që i kemi pasur ne si komision, por ne si grup parlamentar do ta votojmë dhe do të mundohemi ta përcjellim zbatimin e këtij ligji. Për të shkuar më tutje, do ta votojmë dhe do ta përcjellim zbatimin e ligjit gjatë procesit, në qoftë se ka nevojë dhe në kohën sa më fillestare, do të propozojmë edhe ndryshim-plotësim në qoftë se ky ligj has në probleme të çfarëdo natyre gjatë zbatimit.

Po ne sot e biseduam edhe me zotin Haxhiu, e kemi edhe një kërkesë. Zoti Haxhiu e ka propozuar një amendament që ka të bëjë me nenin 11. Neni 11 i zotit Haxhiu ka dy paragrafë. Nën 1, ka paragrafin që përfshihet prej vetë Ligjit të TVSH-së për korporatat dhe nën 2 ka paragrafin që e fut në zbatim Ligjin për sponsorizime. Mirëpo, të dy këta paragrafë dublifikohen, ose dyfishohen dhe komplikohen çështjet që e rregullojnë çështjen e sponsorizimit të ligjit. Pra, e kemi një problem praktik që duhet rregulluar edhe zoti Haxhiu, së paku në parim tha OK. Atëherë, duhet hequr dublifikimet. Çka janë dublifikimet? Neni 1 i parasheh zbritjen prej 10% të të ardhurave të tatueshme dhe neni 2 e shti në veprim zbatimin e Ligjit për sponsorizime. Pra, këtu kemi dublifikim dhe është vështirë, zbatimi e vështirëson e komplikon ligjin në praktikë.

Zoti Haxhiu me siguri do të deklarohet, në qoftë se është kështu. Zoti Haxhiu pajtohet. Ne në parim ose së paku si grup parlamentar do ta votojmë këtë ligj, do ta votojmë amendamentin e zotit Haxhiu me kusht që duhet një monitorim i veçantë i këtij ligji edhe në qoftë se hasim në probleme të çfarëdo natyre ne do ta propozojmë edhe plotësim-ndryshimin e këtij ligji. Po, kemi shpresë që gjatë zbatimit do të hasim në mirëkuptim për ta rregulluar, për ta përmirësuar më tutje, por do të startojmë prej ditës së sotme. Faleminderit!

KRYETARI: Shqipe Pantina, urdhëro!

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryetar!

E para, veç të sqarojmë se ky ligj ka ardhur në Kuvend bashkë me këtë amendament para tre muajve dhe ne qysh atëherë e kemi mbështetur amendamentin e zotit Haxhiu, jo për shkak të presioneve dhe dëshirave apo kërkesave që vijnë nga komuniteti i sportit, por sepse kemi besuar se kjo do t'i ndihmonte zhvillimit në këtë rast të sportit, dhe sepse besojmë se edhe si subjekt i majtë ka fusha në të cilat shteti duhet sa më pak të përzihet, sa më pak të ketë ndikim, por të ndihmojë zhvillimin e tyre. E sporti, kultura, janë këto fusha ku shteti duhet të ketë ndikim pak, por duhet të krijojë mundësinë për zhvillimin e tyre.

Pyetja ime për ju, kryetar, edhe për thirrësit e kësaj seance, ndonëse ne e kemi mbështetur, është: Pse këto çështje nuk janë diskutuar dhe nuk po diskutohen në seanca të rregullta? Pse u desh që për një ligj të tillë, i cili shumë mirë ka mundur të diskutohet, të debatohet, madje edhe të votohet në seancë të rregullt?

Ky ligj është të paktën tri herë hedhur në votim në seancë plenare dhe nuk ka kaluar. Dhe, vetëm pas presioneve të mëdha, tashmë të gjitha subjektet politike e kanë ndryshuar mendjen, që ky qenka ligj i rëndësishëm edhe duhet votuar.

Këto seancat e jashtëzakonshme, Kryetar dhe Kryesi, po na pamundësojnë neve si deputetë kryerjen e një varg çështjeve dhe punëve të tjera. Ka kohë që nuk kemi mbajtur seancë të rregullt. Të paktën mua më janë grumbulluar rreth 20 pyetje parlamentare të cilat nuk po mund t'i shtrojmë, sepse ato shtrohen vetëm në seanca të rregullta. Nuk po mund ta pyesim Qeverinë, e në këtë mënyrë të kërkojmë edhe përgjegjësi prej tyre, për një varg vendimesh, qoftë se po zbatohen keq apo qoftë nëse nuk po zbatohen fare, sepse Kuvendi është shndërruar në diskutim të çështjeve të jashtëzakonshme, edhe për çështje që janë më të zakonshme të mundshme.

Pra, siç kemi bërë para tre muajsh, kur ka ardhur për herë të parë në votim, edhe sot ne do ta mbështesim amendamentin e zotit Haxhiu. Faleminderit!

KRYETARI: Bilall Sherifi. Urdhëro, Bilall. Veç paska qenë gati. Milaim qe gati, po për besë Bilall.

BILALL SHERIFI: Përshëndetjet, i nderuar kryetar!

Kolegë deputetë,

Përfaqësues të sportit,

Sepse edhe pse ligji, apo ky amendament parasheh mundësinë edhe të sponsorizimi të kulturës, s'po shoh dikë nga kultura, ose së paku mua më ka ikur, por sidoqoftë i përshëndesim edhe ata që nuk janë këtu dhe fjalën time do ta fillojë me...

KRYETARI: E ke Adem Mikullovcin, zoti kryetar.

BILALL SHERIFI: E përshëndeta Ademin si koleg deputet.

Do ta filloj me fjalën Qeveria është kundër ligjit. A i bie që Qeveria është kundër sportit? Dhe ai i bie që edhe ata që kanë qenë kundër amendamentit janë me Qeverinë, jo kundër sportit?

Tash t'i lëmë këto. Do të përpiqem të shpjegojë se pse Nisma ka mbështetur dhe mbështet këtë amendament. Pikërisht për faktin se Qeveria dhe qeveritë gjithmonë janë kundër. Qeveria dhe qeveritë kanë dëshirë t'i monopolizojnë sponsorizimet, subvencionet, dhënien e mbështetjeve, sepse përmes asaj rruge ata sigurojnë në njëfarë mënyre të gjitha Qeveritë, thënë më së buti të jenë njerëzit të cilët janë fytyra e parë që i takojnë sportistët. Pra, për nga detyrimi. Njëfarë mënyre i detyrojnë sportistët, njerëzit e kulturës, pastaj që t'i duhen ata. Sepse ata janë që po u japin para. Në fakt, ata nuk u japin paratë e tyre. Ata i japin paratë e shtetit, paratë e publikut. Por, meqë dora e tyre është ajo që i shpërndan paratë e publikut, rrjedhimisht edhe ndikimi është i pashmangshëm.

Pra, unë jam i lumtur që jemi në një situatë ku do të votojmë një amendament që këtë mundësi do t'ua heqë qeverive nga dora. Dhe kjo është gjë e mirë. një.

Dy. Po themi pse të votojmë diçka që u siguron 30 milionë, kur e kanë 300 milionë. A thua pse? Pse nuk vrapojnë të bëjnë presion për të mbetur 300 milionë, por e kërkojnë 30 milionë? Unë jua them unë. Sepse ato 300 milionë janë veresi, ndërsa këto 30 milionë, këta e dinë ku janë, i prekin dhe e dinë sesi i marrin. Pra, kjo është një arsye shtesë që duhet të votohet ky amendament. Edhe mua më vjen mirë, që të gjithë këtu tani, grupet parlamentare, për arsye natyrisht të ndryshme, për motive natyrisht të ndryshme, por kryesisht janë zotuar se do ta votojnë këtë ligj.

Dhe e treta. E treta, për mendimin tim nuk është më pak e rëndësishme. Nëse Qeveria, qeveritë zakonisht janë të prirë të sponsorizojnë vetëm sporte dhe sportistë kulminantë. Ky ligj apo ky amendament do të mundësojë që të spozorizojë kulturën, sportin edhe ta shndërrojë atë edhe në masiv. Pra, edhe sportet më të vogla, apo sportistë më të vegjël, apo fusha më të vogla të cilat qeveritë madje as nuk i shohin, as nuk e dinë që ekzistojnë, do të kenë mundësi që të përfitojnë nga ky amendament.

Pra, janë tri arsye që e bëjnë të domosdoshme ndryshimin, së paku, siç u tha edhe nga kolegët, ndryshimin e sponsorizimit, së pakur për një periudhë të caktuar dhe të shohim në vazhdim se a do të ketë nevojë për të ndryshuar apo jo. Dhe, një fjali nëse më lejoni për keqpërdorimet. Të mos votohet një ligj me paragjykime se do të ketë keqpërdorime, është njëjtë, nëse më lejoni, është njëjtë sikur të themi mos hipni në aeroplan se mund të përplasemi. Po ne hipim, udhëtojmë me aeroplan. Mos dilni në rrugë me vetura, se mund të bëni ndeshje. Po ne hipim, vozitim, ecim, qarkullojmë. Jeta i ka këto. Ama, ama, ne jemi këtu pastaj deputetë, Administrata Tatimore,



zbatuesit e ligjit për ta mbikëqyrur zbatimin e ligjit. Sipas kësaj, nëse ne nuk do të votojmë një ligj, nuk do të votonim këtë ligj për arsyen e keqpërdorimit, nuk do të duhej të votonim ama bash asnjë ligj, pikërisht po për këto arsye. Sepse çdo ligj ka mundësi të keqpërdoret. Jo vetëm ky. Kjo është jeta. Dikush e bën ligjin, dikush e zbaton ligjin, dikush e mbikëqyr ligjin. Dhe unë, ne si kolegë nuk mund të mbahemi përgjegjës për moszbatueshmërinë e ligjit nëse nuk e kanë mbikëqyrur zbatimin e ligjit ata që paguhen po ashtu nga paratë e publikut për të zbatuar ligjin.

Prandaj është koha që sportistët të cilët të gjithë njëzëri kemi thënë kemi talente, po na ka penguar Serbia. Së paku të mos i pengojmë ne. Nëse nuk u kemi ndihmuar në dekada që ata të zhvillohen, talentin e tyre ta zhvillojnë, atëherë së paku tani le të lejojmë atë që e bën e tërë bota, të lejojmë sponsorizimin. Pse jo edhe në këtë formë. Dhe besoni 30 milionë janë një pikë ujë në det për sportin për t'u zhvilluar në përmasat të cilat ne synojmë ta ngremë sportin tonë.

Të mos harrojmë se majat mund të arrihen edhe me më pak investime, por nuk mund të mbahen ato me më pak investimeve. Pra, nëse ne dëshirojmë që jo vetëm t'i arrijmë, po edhe t'i mbajmë, duhet edhe të rrisim, të rrisim nivelin e investimit.

Për fund, nuk besoj që qeveritë, kushdo që vjen, në të ardhmen do të mund të thirret në atë se tani është privatizuar sporti dhe nuk kemi arsye të ndajmë për sport. Unë mendoj që për sport duhet të vazhdohet të ndahet jo vetëm këto, po edhe dyfishin e asaj që është ndarë deri tash për sport edhe kulturë. Ajo e mban në fund të fundit gjallë edhe rininë, edhe të gjithë ata të cilët shesh na lidh për televizori për çfarëdo ndeshje që kemi, qoftë futbollit, qoftë basketbollit, qoftë hendbollit, apo qoftë mundjes, të cilat na kanë ngjitur në majat e larta, e kësaj radhe madje edhe mbi flamurin e Rosisë.

Unë ju uroj sukses të gjithë sportistëve. I inkurajoj të gjithë njerëzit e kulturës, që tani nga miratimi i këtij ligji, të fillojnë të bashkëpunojnë me korporatat, sepse në fund të fundit ky ligj flet për korporatat. Nuk përjashton bizneset e tjera nga sponsorizimi i sportit. Pra, ai 300-milionëshi veresi do të mbetet aty, por veresia është veresi, të gjithë e dimë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Ne do të shkojmë tash drejt. A të ka përmendur a? Jo, në qoftë se ta ka përmendur emrin, urdhëro z. Mikullovcin. Replikë!

**ADEM MIKULLOVCI:** Unë vetëm po dua t'ju them shkurt e shqip, tepër po flasim, tepër po parafrashojmë, tepër po supozojmë. Po na hapet një liqen me ujë të turbullt, ku ka terren mjaft të keq për të zënë peshq nën ujë të turbullt. Po flasim njerëzit që dinë e nuk dinë. Zoti Bilall, fjalim sikur ti, mund të flas bash dy ditë, e mos të them bash kurrëgjë. Kaq desha të them.

**KRYETARI:** Faleminderit! Ta ka përmendur emrin shkurt. Kundër-replikë, zoti Sherifi.

BILALL SHERIFI: Jo veç thashë ta falënderoj bacën Adem për kritikën qëllimmirë, edhe të ecim përpara ta votojmë ligjin.

KRYETARI: Kurr gjë ty, qysh më ka kritikuar mua. Po për besë. A e bëjmë kështu një marrëveshje se kam gabuar i kam përmendur emrat, veç a e lamë nga dy minuta, deputetëve që ua japin fjalën? Një minutë? Marrëveshje një minutë janë vetëm pak, Milaimi, Islami, Armendi, Enveri, Naiti edhe Dauti. Nga një minutë secili. Ju kisha lutur përmbledhëni, ju kisha lutur.

Po vazhdojmë me grupin pa grup, Islam Pacollin. Fjala për ju!

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryetar!

Kolegë të nderuar,

Përfaqësues të sportit që janë këtu,

Me të vërtetë sot është një temë e rëndësishme, por po më vjen keq që ka shumë folklorizëm, po ata që e sponsorizojnë sportin dhe që e përkrahin sportin, janë ditur edhe kur s'ka pasur lehtësira në tatim. Prandaj, ne si AKR e përkrahim fuqishëm. Edhe si familje e përkrahim fuqishëm sportin.

KRYETARI: Faleminderit! Milaim, fjala për ju.

MILAIM ZEKA: Kryetar!

Vetëm desha të them që njerëzit kur hyjnë në politikë, nuk votojnë ligje për qejfin e askujt. Votojnë ligje për ardhmërinë e shtetit edhe të fëmijëve të vet. Tanë këtu po iu bëjmë lajka sportistëve. Kjo flet që ne nuk jemi shtet. Shteti nuk është marrë me sportin. Sot i vetmi njeri që është dashur të dalë të flasë në foltore, është ministri Bedri Hamza, ministri për Ekonomi dhe Financa. Nuk mund të shkojmë përpara me amendamente qysh i teket çdo deputeti këtu dhe çdo propozim që bëhet nga shumica absolute e deputetëve, flasin vetëm për vota, se mendojnë që nesër kanë për të rrejtur t'ua marrin ndonjë votë.

Po të ishim ne që ua qajmë hallin sportistëve, ne kishim bërë buxhet për sportistë, e para.

E dyta, po të ishim ne që i duam korporatat, korporatave ua heqim tatimin në doganë, edhe ua...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Daut Haradinaj, urdhëro!

DAUT HARADINAJ: Kryetar!

Të them të drejtën, unë kur e lypa fjalën, nuk e lypa që të flas për ligjin, por e di që edhe deputeti Haxhiu, edhe shumica e grupeve parlamentare janë pajtuar, edhe propozimi im ishte që të shkojmë direkt me votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nait, urdhëro!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Edhe një herë vetëm t'u kujtoj deputetëve, kur e kemi miratuar këtë Projektligj, Komisioni ka qenë në Frankfurt, në Republikën Gjermane, edhe ligji është model gjerman. Edhe deputetët nuk kanë nevojë të frikësohen nga modeli gjerman i ligjit. Prandaj, ta votojnë ligjin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Hoti, Enver fjala për ju. Deputeti i fundit. Ministri dhe propozuesi në fund.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar!

Mendoj që ne kemi pasur një bashkëpajtim në seancën e kaluar që të votojmë dhe votimi ka dështuar. Unë si përfaqësues në Komisionin për Buxhet e mora fjalën, sepse Kryetari i Komisionit e ka bërë një gabim, qëllimshëm apo pa qëllimshëm nuk e di në seancën e kaluar, por me gjasë i ka pasur të gjitha mundësitë ta ftoj Komisionin për Buxhet, t'i ndjekë të gjitha normat dhe të realizojë. Nuk mund të shkojmë me dy qëndrime, edhe po dua të përkrah amendamentin e zotit Haxhiu, edhe po dua të mbrojë amendamentin e Komisionit që e kemi marrë bashkërisht. Duhet vendosur grupi parlamentar i LDK-së, edhe kryetari i Komisionit, do ta përkrahë amendamentin e z. Haxhiu apo nuk do ta përkrahë? Qëndrimi dual nuk është efikas, nuk është në shërbim të thirrjes për çka jemi sot këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E kemi zgjedhur. Unë do ta bëj pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Ministër, fjala për ju. Edhe propozuesve, është gati, jemi në votim.

KUJTIM GASHI: Faleminderit i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Unë vetëm për ta sqaruar këtë pjesën e dilemave të keqpërdorimeve, pa dashur për të paragjykuar mundësinë për të keqpërdorur.

Siç e dini, vitin e kaluar në raport me Ligjin për sponsorizime, ne e kemi nxjerrë edhe një rregullore për përcaktimin e kriterëve, pra për procedurat, në të njëjtën kohë edhe për dhënien e donacioneve. Dhe më lejoni që vetëm nenin 7 ta lexoj të kësaj rregulloreje, edhe besoj që qartësohemi te kjo pjesa e dilemave sa i përket keqpërdorimeve. Procedura e dorëzimit të

kërkesës, neni 7 thotë: përfituesi i sponsorizimit i drejtohet me kërkesë me shkrim Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për shqyrtimin dhe vërtetimin e sponsorizimit, pasi të jenë siguruar paraprakisht aprovimi në rastet si: 1. Sportisti individual siguron aprovimin nga klubi i tij ose klubi i saj dhe nga federata përkatëse. Klubi përkatës siguron aprovimin nga federata përkatëse. Federata përkatëse siguron konfirmimin nga Komiteti Olimpik i Kosovës dhe Komiteti Olimpik i Kosovës aplikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Siç dihet pra është një mekanizëm i tërë edhe i kontrollit.

Dhe, po ashtu më lejoni që edhe te pjesa e auditimit, pra e kemi nenin 12, pika 5, të gjithë përfituesit e sponsorizimit në vlerë prej 10 mijë eurosh e më shumë, janë të obliguar që ta sjellin raportin e auditimit për vitin paraprak në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Prandaj, është bërë një mekanizëm i tërë dhe i kontrollit, te kjo pjesa e dilemave për keqpërdorime.

Të nderuar deputetë,

Edhe një herë ju ftoj, edhe në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, që ta votoni këtë amendament dhe t'i jepni rrugë dhe mundësi implementimit të Ligjit për sponsorizim. Andaj, ky votim që do të ndodhë sot, do të më shumë medalje për sportistët e vendit tonë dhe më shumë çmime për artistët në fushën e artit dhe kulturës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Bekim Haxhiu në emër të propozuesit, edhe shkojmë në votim. Do t'i lusja deputetët që të kthehen në sallë, se do të shkojmë në votim. Votimi do të bëhet në mënyrë elektronike.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar përfaqësues të federatave sportive, të klubeve

Sportistë, trajnerë të gjithë të pranishëm që sot jeni këtu,

Amendamentin të cilin e kam bërë kur ka ardhur Ligji për të Ardhurat në Korporata e kam bërë me arsyen se ligji të cilin e votuam në Kuvend nuk gjeti zbatim. Nuk gjeti zbatim, sepse Administrata Tatimore për shkak të mosharmonizimit të këtij ligji, në veçanti nenit 12, të Ligjit për sponsorizime, ku parashihen zbritjet e lejuara 30% për fushën e sportit dhe 20% për fushën e kulturës, Administrata Tatimore nuk e mori në konsideratë, sepse duhej t'i referohej ligjit bazik.

Pse atëherë e bëmë 30% për sportin dhe 20% për kulturën? Sepse kultura financohet drejtpërdrejt edhe prej sportit, prej buxhetit të shtetit, ndërsa sporti jo. Pra, e dini që edhe buxheti për teatrin për Ansamblin 'Shota' dhe shumë institucione tjera kulturore financohen drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit.

Por, nëse duam ta bëjmë atë që duhet bërë për sportin që biznesi ta përcaktojë interesin e tij se ku do të investojë.

Proksimalisht po themi ose përafërsisht nëse këto 30 milionë që do t'i përfitojë drejtpërdrejt sporti, do të jenë në dorë të biznesit në bazë të kriterëve të përcaktuara se ku dëshiron të investosh.

A dëshiron të investosh në klubin futbollistik Trepça, në Prishtinë a në Vllaznim a kudo. Po jo ta përcaktojë ministri ose Qeveria se ku do të shkojnë. Sikur të isha unë, ndoshta do të shkonin në Trepçë, sikur të ishte Ismeti do t'i çonte në Prishtinë ose ndoshta në ndonjë mënyrë tjetër të përcaktohet.

Biznesi e ka të drejtën e vet që ta përcaktojë se ku do të shkojë kjo mundësi e financimit. Sigurisht, se për këtë arsye e kemi bërë këtë amendament, i cili ka ardhur në lexim të parë me 7 mars, nuk e ka marrë vëmendjen e duhur. Por, që sot duke iu falënderuar sportistëve tanë, në veçanti sportistëve, kombëtares sonë në futboll dhe sukseseve të fundit të Majlinda Kelmendit, Norës, Lorianës e të Driton Kukës në Minsk, e sensibilizojë edhe më shumë këtë nevojë që vërtetë, ne duhet ta kemi një kujdes të veçantë për sportin.

Fati i mirë deshi që ky amendament është tani në votim, dhe e kemi një mundësi që vërtetë në këto momente të vazhdojmë tutje. Kjo ka buruar nga rekomandimi i cili ka dalë në debatin e parë për sportin. Ligji për sponsorizim ka qenë kërkesë e komunitetit sportiv.

Prandaj, po e votojmë dhe unë do ua lexoj edhe njëherë për sqarimin tuaj që ta dini gjithsecili nga ju se çfarë po votojmë, dhe duke ju falënderuar për përkrahjen të cilën e deklaruat.

Prandaj, po e lexoj edhe njëherë duke e marrë në konsideratë edhe vërejtjen që e dha zoti Kuçi, po e lexoj amendamentin në tërësi.

**KRYETARI:** Më fal, i nderuar deputet! Unë do ta lexoj për shkak se do t'i bëjë... Jo, kur e vë në propozim... Amendamentin lexoje por kur e vë në propozim... Lexoje, të lutem!

Kur ta vë në propozim dhe për votim e lexoj unë. Ta keni parasysh, amendamentin 6 të cilin e kemi kaluar proceduralisht. A bëjmë të njëjtin votim. Ai le ta lexojë amendamentin e vet, por po flas për amendamentin 6 që e kemi kaluar, ngase nuk ka kuptim dy amendamente për të njëjtin çështje. Ju lutem, kjo është. Urdhëro!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar për sqarimin të cilin e dhatë. Pra, amendamenti im, amendamenti 5 i propozuar është ky: Zbritjet e lejuara për aktivitete me interes publik.

Pika 1.1 e nenit 11: Kontributet e dhëna nga tatimpaguesit që mbajnë libra dhe regjistrime sipas paragrafit 5, nenit 35 të këtij ligji, në formë të donacionit dhe sponsorizimeve për qëllime humanitare, shëndetësore, edukativo-arsimore, fetare, shkencore, mbrojtje të ambientit sipas këtij ligji konsiderohen si kontribute të dhëna për interes publik dhe lejohen si shpenzime deri në maksimum prej 10% të të ardhurave që taten e të llogaritura para se të jetë zbritur ky kontribut.

Pika 1.2: Kontributet e dhëna nga tatimpaguesit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, llogariten sipas Ligjit nr. 05/L-090 për Sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit dhe ku në nenin 12 precizohet se zbritjet e lejuara për 30% për sportin nga tatimi në fitim dhe 20% për fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Pastaj janë edhe pika 3 dhe 4, ku precizohen edhe tatimet e sponsorizimeve dhe të reklamave.

Prandaj, unë kërkoj nga ju votën tuaj që vërtetë ta ndihmojmë zhvillimin e sportit ashtu siç e meritojnë dhe kërkojnë sportistët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Amendamenti 5, propozim i deputetit Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional, votimi i të cilit nënkupton menjëherë se amendamenti 6 mbetet pa objekt dhe fshihet. Këtë e kemi kaluar në seancat paraprake.

Do të thotë, përgatitemi për votim dhe votojmë tash. 79 deputetë, 79 për. Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara, votojmë tash. 75 deputetë, 76, një me dorë, deputeti Zafir Berisha. 73 për, 74 përkatësisht një me dorë për dhe asnjë kundër. 2 abstenime.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-105 për tatimin në ardhurat e korporatave.

Me këtë i mbyll punimet e seancës së jashtëzakonshme dhe vazhdojmë me seancën e radhës. Urime edhe sportistëve!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*